

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT

PROPOZUES: Shërbimi profesional i Fondit

PËRGATITËS: Sektori për çështje financiare

RAPORTUES: Fatime Nexhipi, drejtoresh; Sektori

PROPOZIM NDAJ KËRKESËS BUXHETORE

të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2026

Shkup, gusht 2025

Bazuar në nenin 157 pika 3 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18, 245/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23, 193/24, 75/25 dhe 154/25), Ligjit për Buxhetet („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 203/22, 59/23, 39/24, 76/24, 272/24 dhe 3/25) dhe nenit 33 paragrafi 2 të Statutit të Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 174/2013), Këshilli Drejtues i Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht të vitit 2025, miratoi:

PROPOZIM NDAJ KËRKESËS BUXHETORE

të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2026

/

Shkup, gusht viti 2025

I. PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Buxheti i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 përbëhet nga:

I. Gjithsej të ardhura 149.380.050.000 denarë

edhe atë:

- të ardhura burimore dhe të tjera 89.227.100.000 denarë

- të ardhura nga transferta 60.152.950.000 denarë

II. Gjithsej shpenzime 149.380.050.000 denarë

edhe atë:

- qëllime të përcaktuara 149.380.050.000 denarë

Neni 2

Të ardhurat sipas burimeve dhe llojit të të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të qëllimeve kryesore përcaktohen si vijon:

66004 Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut				
Bilanci i të ardhurave sipas zërit dhe destinimit			136.969.289.000	149.380.050.000
Kategoria	Zëri	Përshkrimi	Projeksioni i Buxhetit deri në fund të vitit 2025 sipas Ribalancit	Projeksion i Buxhetit për vitin 2026
71		TË ARDHURA TATIMORE	82.876.500.000	88.817.100.000
71	712	Kontribute për sigurim social	81.076.500.000	86.981.100.000
71	714	Tatimet e vendit të mallrave dhe shërbimeve	1.800.000.000	1.836.000.000
72		TË HYRA TË PATATUARA	500.000.000	400.000.000
72	723	Taksa dhe kompensime	150.000.000	100.000.000
72	725	Të ardhura të tjera që nuk tatimohen	350.000.000	300.000.000
73		TË ARDHURA KAPITALE	10.000.000	5.000.000
	734	Të ardhura nga dividendët	10.000.000	5.000.000
74		TRANSFERIME DHE TATIME	53.572.789.000	60.152.950.000
74	741	Transferime nga nivele të tjera të pushtetit	53.572.789.000	60.152.950.000
77		SHITJA E LETRAVE ME VLERË	10.000.000	5.000.000
77	771	SHITJA E LETRAVE ME VLERË	10.000.000	5.000.000
Bilanci i shpenzimeve sipas zërit dhe destinimit			136.969.289.000	149.380.050.000
40		PAGA DHE KOMPENSIME	379.689.000	512.000.000
	401	Paga bazë	270.549.000	362.880.000
	402	Kontribute për sigurim social	101.140.000	141.120.000
	404	Kompensime	8.000.000	8.000.000
42		MALLRA DHE SHËRBIME	171.200.000	241.200.000
	420	Shpenzime ditore dhe të rrugës	700.000	1.000.000
	421	Shërbime komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	60.500.000	69.200.000
	423	Materiale dhe inventar i imët	11.240.000	20.050.000
	424	Riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse	54.840.000	71.800.000
	425	Shërbime kontraktuese	36.080.000	70.100.000
	426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	7.840.000	9.050.000
	427	Punësime të përkohshme	0	0
46		SUBVENCIONE DHE TRANSFERTA	24.591.000	32.300.000
	463	Transferta tek organizata joqeveritare	1.500.000	1.500.000
	464	Transferta të ndryshme	17.800.000	17.800.000
	465	Pagesa për dokumente përmbartuese	5.291.000	13.000.000
47		BENEFICIONE SOCIALE	136.353.809.000	148.479.550.000
	472	Pagesa e beneficioneve nga Fondi i SPIMV-së	136.353.809.000	148.479.550.000
48		SHPENZIME KAPITALE	40.000.000	115.000.000
	480	Blerja e pajisjeve dhe makinave	20.000.000	45.000.000
	481	Objekte ndërtimtare	20.000.000	20.000.000
	485	Investime në mjete jo-financiare	0	50.000.000
	486	Blerje automjesh	0	0
II Pjesë e veçantë			136.969.289.000	149.380.050.000
1		ADMINISTRATA	595.229.000	872.500.000
10		Administrata	595.229.000	872.500.000
40		Paga dhe kompensime	379.689.000	512.000.000
	401	Paga bazë	270.549.000	362.880.000
	402	Kontribute për sigurim social	101.140.000	141.120.000
	404	Kompensime	8.000.000	8.000.000
42		MALLRA DHE SHËRBIME	164.740.000	234.700.000
	420	Shpenzime ditore dhe të rrugës	700.000	1.000.000

	421	Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	56.000.000	64.700.000
	423	Materiale dhe inventar i imët	11.200.000	20.000.000
	424	Riparime dhe mirëmbajtje investuese	53.040.000	70.000.000
	425	Shërbime kontraktuese	36.000.000	70.000.000
	426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	7.800.000	9.000.000
	427	Punësime të përkohshme	0,00	0,00
46		SUBVENCIONE DHE TRANSFERTA	15.800.000	15.800.000
	464	Transferta të ndryshme	15.800.000	15.800.000
	465	Transferta për dokumente përmbartuese	0,00	0,00
48		SHPENZIME KAPITALI	35.000.000	110.000.000
	480	Blerja e pajisjeve dhe makinave	20.000.000	45.000.000
	481	Objekte ndërtimtarie	15.000.000	15.000.000
	485	Investime dhe mjete jofinanciare	0,00	50.000.000
	486	Blerja e automjeteve	0,00	0,00
2		SIGURIMI PENSIONAL DHE INVALIDOR	136.361.100.000	148.494.550.000
20		Sigurimi pensional dhe invalidor	136.361.100.000	148.494.550.000
47		BENIFICIONE SOCIALE	136.361.100.000	148.494.550.000
46		Transferta të ndryshme	7.291.000	15.000.000
	464	Transferta të ndryshme	2.000.000	2.000.000
	465	Pagesa sipas dokumenteve ekzekutive	5.291.000	13.000.000
	472	Pagesa e beneficioneve nga Fondi për SPIMV	136.353.809.000	148.479.550.000
3		AKOMODIM NË KONVIKT I FËMIJËVE ME PENGESA NË ZHVILLIMIN PSIKOFIZIK	1.500.000	1.500.000
30		Akomodim në konvikt i fëmijëve me pengesa në zhvillimin psikofizik	1.500.000	1.500.000
46		SUBVENCIONE DHE TRANSFERTA	1.500.000	1.500.000
	463	Transferta tek organizatat joqeveritare	1.500.000	1.500.000
4		SHPENZIME PËR SHTËPITË PËR BANIM TË SHFRYTËZUESVE TË PENSIONIT	11.460.000	11.500.000
40		Shpenzimet për shtëpitë për banim të shfrytëzuesve të pensionit	11.460.000	11.500.000
42		MALLRA DHE SHËRBIME	6.460.000	6.500.000
	421	Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	4.500.000	4.500.000
	423	ateriale dhe inventar i imët	40.000	50.000
	424	Riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse	1.800.000	1.800.000
	425	Shërbime kontraktuese	80.000	100.000
	426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	40.000	50.000
48		SHPENZIME KAPITALI	5.000.000	5.000.000
	481	Objekte ndërtimtarie	5.000.000	5.000.000

Neni 3

Buxheti i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 do të zbatohet nga 1 janari i vitit 2026 paa harmonizimit paraprak me Ministrinë e Financave dhe miratimit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02- 3547/1
29.08. 2025
Shkup

NËNKRYETARE E KËSHILLIT DREJTUES

Diana Ristovska - Dodevski

ARSYETIM

i Propozimit për Kërkesën Buxhetore të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2026

I. Pjesa e përgjithshme

Buxheti i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 paraqet një plan vjetor të të ardhurave dhe shpenzimeve për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, si dhe kryerjen pa pengesa dhe në kohë të detyrimeve që dalin nga qëllimet dhe detyrat.

Buxheti është një instrument përmes të cilit financohen funksionet e Fondit. Ai pasqyron vazhdimësinë në zbatimin e aktiviteteve për sigurimin e rregullt dhe në kohë të mjeteve nga kontributet dhe burimet tjera të parashikuara me ligj, për pagesën e rregullt dhe në kohë të pensioneve dhe të gjitha të drejtave tjera, si dhe përmirësimin e standardit jetësor të shfrytëzuesve të pensionit dhe përfituesve të tjerë. Buxheti ka rëndësi të madhe ekonomike dhe sociale si pjesë e politikës ekonomike të shtetit.

Buxheti i Fondit të SPIMV-së për vitin 2026 është përgatitur sipas qarkores buxhetore të pranuar nga Ministria e Financave nr. 08-6695/1 nga data 13.06.2025, në të cilën përmbahen udhëzimet kryesore për përgatitjen e Propozim-Kërkesës Buxhetore për vitin, në përputhje me indikatorët makroekonomikë të pritshëm për zhvillimin e Republikës në vitin 2026. Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të Fondit është bërë duke u bazuar në nivelin e detyrimeve të Fondit në vitin 2025 dhe detyrimet e reja të pritshme për vitin 2026 që dalin nga zbatimi i sigurimit pensional dhe invalidor.

Proceset zhvillohen në përputhje me rregullativën ligjore, Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, qëllimet e përcaktuara të Fondit në Planin Strategjik për periudhën 2026–2028, si dhe udhëzimet e Këshillit Drejtues të Fondit për qëllimet dhe detyrat prioritare për punën e Fondit në vitin 2026.

Gjatë përgatitjes së Buxhetit të Fondit janë marrë parasysh edhe rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shpenzim ekonomik dhe racional të mjeteve për shpenzimet rrjedhëse, me kufizimin e tyre për vitin 2026.

Qëllimet prioritare në punën e Fondit për vitin 2026 janë:

- Sigurimi i mjeteve të nevojshme për pagesën e rregullt dhe në kohë të pensioneve dhe të drejtave të tjera që rrjedhin nga sigurimi pensional dhe invalidor.
- Pagesa e rregullt dhe në kohë e mjeteve për fondin solidar për shfrytëzuesit e ndjerë të pensionit.
- Përmirësimi i sigurisë materiale dhe sociale i shfrytëzuesve të pensionit përmes harmonizimit të pensioneve, në përputhje me dispozitat ligjore.
- Shpërndarja e saktë, e vazhdueshme dhe në kohë, si dhe kontrolli i kontributeve ndërmjet Fondit dhe fondeve private pensionale, dhe përfshirja e të punësuarve të rinj në sigurim, sipas Ligjit.
- Marrja e rregullt e të dhënave për kontributet e paguara nga Drejtoria për të Ardhura Publike për stazhin dhe pagat e të siguruarve në bazën e të dhënave të Fondit, për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor.

- Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe në kohë për shfrytëzuesit gjatë realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor.
- Mbledhja e kontributeve të papaguara deri në vitin 2008 përmes ndërmarrjes së masave për mbledhjen e tyre.
- Aktivitetet e vazhdueshme për parandalimin e realizimit dhe pagesës së paarsyeshme dhe të paligjshme të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor.
- Zbatimi i përpiktë i të gjitha dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Përmirësimi i sistemit informativ si mbështetje teknike në zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor.
- Përmirësimi i kushteve të jetesës për shfrytëzuesit e pensionit në shtëpitë që menaxhohen nga Fondi.

Në vitin 2026, Fondi do të vazhdojë me të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizimin e qëllimeve prioritare dhe detyrave të tjera që dalin nga Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Statuti dhe aktet e tjera të Fondit, si dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Sigurimin Pensional me Financim Kapital.

Parakushtet themelore gjatë projektimit të Buxhetit të Fondit për vitin 2026 janë si vijon:

a) Në pjesën e të ardhurave:

- zbatimi i shkallës së kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor prej **18,8%**,
- rritje e pagave mesatare për **5,4%**,
- rritje e numrit të të punësuarve për **1,6%**.

b) Në pjesën e shpenzimeve:

- harmonizimi ligjor i pensioneve bazuar në Ligjin për Ndryshimin e Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e RMV nr. 154 nga 29 korriku 2025), ku në nenin 2 të ndryshimeve rregullohet mënyra e harmonizimit të pensioneve, harmonizimi bëhet në mënyrë që nga shuma totale mujore e përfituar nga përqindja e rritjes së pensioneve, e llogaritur si shumë prej 50% të rritjes së indeksit të kostos së jetesës dhe 50% të rritjes së pagës mesatare të paguar për të gjithë të punësuarit në RMV në gjysmën e parë të vitit krahasuar me gjysmën e mëparshme, e publikuar nga ESHS, të ndahet me numrin total të shfrytëzuesve të pensionit që kanë realizuar të drejtën e pensionit deri më 28 shkurt të vitit 2026 dhe përqindja e projektuar prej 2,7% për harmonizimin e pensioneve të realizuara në shtator të vitit 2026.
- hyrje e shfrytëzuesve të rinj të pensionit për **1,0%**.

Bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara të Fondit për periudhën janar-qershor, si dhe vlerësimet deri në fund të vitit 2025 dhe të dhënat e përmendura sipas Ribalancimit të Buxhetit për vitin 2025, të ardhurat dhe shpenzimet e balancuara arrijnë në 136.969,29 milionë denarë.

Shërbimi profesional i Fondit do të ndjekë dhe analizojë rregullisht gjendjen financiare gjatë gjithë vitit dhe do të informojë Këshillin Drejtues të Fondit, Ministrinë për Politikë Sociale, Demografi dhe Rini,

Ministrinë e Financave dhe institucionet tjera shtetërore, për marrjen me kohë të masave për realizimin pa pengesa të funksioneve të Fondit.

II. Projekti i të ardhurave dhe shpenzimeve

Fondi në vitin 2026 do t'i realizojë funksionet brenda kuadrit të të ardhurave të planifikuara gjithsej në vlerë prej 149.380,05 milionë denarë, të cilat do të financohen nga të ardhurat e vlerësuara në të njëjtin nivel prej 149.380,05 milionë denarë.

Sipas projeksioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve të Fondit, deficitin për vitin 2026 është planifikuar në vlerë prej 41.682,95 milionë denarë.

Të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit sipas viteve janë si më poshtë:

Të ardhura përkatësisht shpenzime	Të realizuara 2022	Të realizuara 2023	Të realizuara 2024	2025- vlerësime sipas Ribalancit	Plani 2026-
1. TË HYRA					
Të ardhura burimore	54.943,42	63.340,97	71.435,62	81.076,50	86.981,10
Të ardhura nga akcizat	1.444,91	1.492,03	1.624,15	1.800,00	1.836,00
Të ardhura nga Buxheti i RMV-së	28.587,93	31.378,76	42.473,72	53.572,79	60.152,95
Obligime të rregullta sipas ligjit	2.663,92	1.500,00	1.842,38	2.000,00	2.000,00
2. Mbulim i deficitit	14.850,58	16.515,50	23.119,60	35.057,79	41.682,95
3. Shpenzime transitorie	10.559,00	12.400,00	15.300,00	16.000,00	15.955,00
4. Transfer nga Ministria e Mbrojtjes	514,43	522,92	515,00	515,00	515,00
5. Të ardhura nga mbështetja financiare për shfrytëzuesit e pensionit	0,00	440,34	1.696,74	0,00	0,00
- Të ardhura të tjera	136,86	131	144,79	500,00	400,00
- Të ardhura nga dividendat	12,11	9,72	17,70	10,00	5,00
- Të ardhura nga shitja e aksioneve dhe pjesëve	0,00	0,24	0,00	10,00	5,00
Gjithsej të ardhura	85.125,23	96.352,72	115.695,98	136.969,29	149.380,05
2. SHPENZIME					
-Pensione	67.569,30	77.965,32	90.646,54	106.515,00	117.162,88

- Shpenzime transitorë	10.825,13	12.172,58	14.221,46	16.000,00	15.955,00
- Kompensime nga sigurimi invalidor	89,23	100,60	110,19	126,31	132,00
- Kontribut për sigurim shëndetësor	8.607,55	8.664,41	9.664,56	13.714,00	15.231,17
-Paga dhe kompensime për të punësuarit	258,34	308,61	363,13	379,69	512,00
-Shpenzime për shërim në banjë dhe transport për pensionistët	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
- Shpenzime të tjera	257,82	255,24	244,78	234,29	387,00
Gjithsej shpenzime	87.607,37	99.466,76	115.250,66	136.969,29	149.380,05
3. Tepricë e të ardhurave përkatësisht shpenzimeve	-2.482,14	-3.114,04	445,32	0,00	0,00

Në Buxhetin e Fondit si plan vjetor i të ardhurave dhe shpenzimeve janë përfshirë të hyrat e planifikuara nga kontributet, nga mjetet e Buxhetit të Vendit, nga akcizat e derivateve të naftës, nga shitja e aksioneve dhe pjesëve dhe dividendës si dhe të ardhura të tjera. Në pjesën e të ardhurave janë përfshirë shpenzimet për pensione dhe kompensime, kontributi për sigurim shëndetësor, shpenzime transitive, shpenzime për pagat e të punësuarve, shpenzime kapitale dhe shpenzime të tjera për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor.

Të hyrat totale të Fondit janë planifikuar në shumë prej 149.380,05 milionë denarë, ku pjesa më e madhe përbëhet nga të hyrat burimore me 58,23%, dhe mjetet nga Buxheti i Republikës me 40,27%.

Pjesëmarrja e të ardhurave burimore në të hyrat totale është rritur në 58,23% me normën e kontributit prej 18,8%, ndërsa në vitin 2018 kjo pjesëmarrje ishte 55,17% me normë kontributi prej 18%.

Të hyrat për vitin 2026 janë planifikuar të realizohen nga burimet e mëposhtme:

- Mjetet nga kontributet në shumë prej 86.981,10 milionë denarë, nga të cilat 15.955,00 milionë denarë do të transferohen në fondet private pensionale për të punësuarit dhe anëtarët e rinj në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.
- Brenda të ardhurave burimore nga kontributi nga paga, janë planifikuar mjete në shumë prej 84.270,11 milionë denarë. Si bazë për planifikimin e këtyre të ardhurave janë marrë mjetet e planifikuara nga kontributet nga paga në Buxhetin e Fondit për vitin 2025, që ishin 78.553,74 milionë denarë.
- Nga Buxheti i Republikës, janë planifikuar mjete në shumë prej 60.152,95 milionë denarë, nga të cilat: 2.000,00 milionë denarë për mbulimin e pensioneve më të favorshme, pensioneve ushtarake, pensioneve minimale për bujqit, 41.682,95 milionë denarë për mbulimin e deficitit të Fondit, 15.955,00 milionë denarë për mbulimin e shpenzimeve tranzitore dhe 515,00 milionë denarë si transfer nga Ministria e Mbrojtjes.
- Nga akcizat e derivateve të naftës, mjete në shumë prej 1.836,00 milionë denarë;

- Nga të hyrat e tjera, mjete në shumë prej 400,00 milionë denarë;
- Nga të hyrat nga dividenda, mjete në shumë prej 5,00 milionë denarë;
- Nga shitja e aksioneve dhe pjesëmarrjeve, mjete në shumë prej 5,00 milionë denarë.

1. Të hyrat nga kontributet

Të ardhurat nga kontributet e Fondit sigurohen nga kontributet pagat e të punësuarve, kontributi nga të ardhurat për stazhin e sigurimit që llogaritet me kohëzgjatje të shtuar (stazh i benifikuar), kontributet nga pagat e personave fizikë që ushtrojnë veprimtari të pavarur dhe të punësuarit tek ata, nga bujqit individualë dhe kontributi nga Agjencia për Punësim për kompensimin që paguan për personat e papunë përkohësisht. Nga të gjitha këto burime planifikohet të realizohen mjete si më poshtë:

a) Të ardhura nga kontributet nga pagat për vitin 2026 janë planifikuar në vlerë prej **84.270,11 milionë denarë**. Këto të ardhura janë planifikuar bazuar në të hyrat e planifikuara nga kontributet nga pagat sipas Ribalancimit të Buxhetit të Fondit deri në fund të vitit 2025, prej **78.553,74 milionë denarë**, dhe janë rritur sipas rritjes së pagave bruto me **5,4%** dhe rritjes së punësimit me **1,6%** që parashikohet të realizohet në vitin 2026 dhe shkallës së kontributit për SPI prej **18,8%**. Pjesëmarrja e kontributit nga pagat planifikohet të jetë **56,41%** në raport me total të hyrat e planifikuara.

Në vitin 2026, për fondet private pensionale planifikohet të ndahen dhe transferohen mjete në shumë prej **15.955,00 milionë denarë**, të cilat Fondi i mbledh në një procedurë të unifikuar si për veten ashtu edhe për fondet private pensionale, ndërsa shpërndarja bëhet bazuar në numrin e të siguruarve të regjistruar. Shkalla e kontributit për shtyllën e dytë pensionale është **6%** nga baza për pagesën e kontributit e përcaktuar me ligj. Në vitin 2025, numri i anëtarëve planifikohet të jetë rreth **628.637**. Numri i të punësuarve në shtyllën e parë zvogëlohet për shkak të daljes në pension të personave që nuk janë të regjistruar në shoqëritë private pensionale, ndërsa numri i të siguruarve në shtyllën e dytë rritet për shkak të regjistrimit të detyrueshëm të të punësuarve të rinj.

b) Nga kontributi nga të ardhurat për stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar planifikohen mjete në shumë prej **848,97 milionë denarë**. Këto të ardhura janë rritur krahasuar me vlerësimet për vitin 2025, bazuar në rritjen e pagave dhe punësimit të planifikuar për vitin 2026.

c) Nga personat fizikë që ushtrojnë veprimtari të pavarur dhe të punësuarit tek ata planifikohen mjete në shumë prej **1.645,59 milionë denarë**, dhe pritet që të rriten si në periudhën e mëparshme.

d) Të ardhurat nga bujqit individualë planifikohet të realizohen në shumë prej **214,18 milionë denarë**, dhe krahasuar me vlerësimet për vitin 2025 të njëjtat janë më të larta, pasi çdo vit rritet interesi për regjistrim dhe pagesë të kontributeve nga bujqit individualë.

e) Të ardhurat nga Agjencia për Punësim planifikohen në shumë prej **2,25 milionë denarë**. Në pjesën e realizimit të mjeteve nga kontributet, Fondi do të ndër marrë të gjitha masat ligjore për rritjen dhe sigurimin e mbledhjes më efikase të kontributeve që dalin nga rregullativa ligjore, dhe do të vazhdojë me ndër marrjen e masave për mbledhjen e kontributeve të papaguara deri më 31.12.2008. Do t'i ndjekë

rregullisht të dhënat për kontributet e mbledhura nga DAP dhe do të kryejë shpërndarjen e mjeteve të fondet private pensionale.

2. Të ardhurat nga Buxheti i Republikës

Të ardhurat nga Buxheti i Republikës parashikohen në shumën prej **60.152,95 milion denarë**, dhe atë:

Për detyrimet e rregullta – pensionet e realizuara në kushte më të favorshme, pensionet ushtarake dhe pensionet minimale bujqësore, mjete në shumën prej **2.000,00 milion denarë**; **41.682,95 milion denarë** për mbulimin e deficitit aktual; **15.955,00 milion denarë** për shpenzimet tranzitore për të punësuarit që kanë hyrë ose do të hyjnë në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital; dhe **515,00 milion denarë** për mbulimin e pagesës së pensioneve sipas Ligjit për ARM deri në përmbushjen e kushteve sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor.

Pjesëmarrja e të ardhurave nga Buxheti i Republikës në të hyrat totale të Fondit planifikohet të jetë **40,27%**.

Për realizimin e detyrimeve të Buxhetit të Republikës ndaj Fondit, çdo muaj do të dorëzohet një llogaritje me kuantifikimin e detyrimeve sipas të gjitha bazave.

3. Të ardhurat nga akciza

Të ardhurat nga akcizat të cilat llogariten sipas shkallës prej 9,18% nga akciza e shitjes së derivateve të naftës, planifikohen në shumën prej 1.836,35 milion denarë. Këto mjete janë planifikuar në bazë të mjeteve të vlerësuara në vitin 2025 dhe shkallës së planifikuar të rritjes së shpenzimeve të jetesës prej 2,0%. Të ardhurat nga akcizat marrin pjesë me 1,23% në totalin e të ardhurave të Fondit .

4. Të ardhurat nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve të Fondit

Të hyrat nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve të Fondit në vitin 2026 parashikohen të realizohen në shumë prej 10,00 milion denarë, edhe atë: 5,00 milion denarë nga dividenda dhe 5,00 milion denarë nga shitja e aksioneve dhe pjesëve.

5. Të ardhura tjera

Në vitin 2026 në bazë të të ardhurave të tjera parashikohet të realizohen mjete në shumë prej 400,00 milion denarë. Këto të ardhura kanë të bëjnë me mjetet nga vende të tjera për mbulimin e pensioneve të shfrytëzuesve të pensionit të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë, qiratë, të hyrat nga kompensimi i dëmeve, të hyrat nga pensionet e kthyera, dividenda nga Banka Komerciale dhe të tjera. Pjesëmarrja e këtyre mjeteve në totalin e të ardhurave të Fondit është vetëm 0,27%.

III. Obligimet e Fondit

Shpenzimet totale të Fondit për vitin 2026 planifikohen në shumë prej 149.380,05 milion denarë. Me këto mjete planifikohet që të kryhet pagesë e rregullt e pensioneve për të gjithë shfrytëzuesit e pensionit si dhe për shfrytëzuesit e rinj që do ta fitojnë të drejtën gjatë vitit 2026; bartja e kontributeve në llogaritë individuale të anëtarëve të fondeve pensionale private, pagesa e kontributit për sigurim shëndetësor të shfrytëzuesve të pensionit; pagesa e kompensimeve nga sigurimi invalidor, pagesa e pagës për punonjësit, shpenzime të tjera për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor.

1. Shpenzime për pensione

Në vitin 2026, planifikohet që për pagesën e pensioneve të shpenzohen mjete në shumë prej 117.162,88 milion denarë apo 78,43% të gjithsej shpenzimeve, ndërsa së bashku me kontributin për sigurim shëndetësor (bruto pensione) pjesëmarrja është 88,63%. Këto shpenzime përfshijnë të gjitha llojet e pensioneve edhe atë: për pagesën e pensioneve të rregullta nga sigurimi i punës (pensionet e pleqërisë, invalide dhe familjare), pensione minimale bujqësore, pensionet ushtarake, pagesën e pensioneve jashtë vendit dhe për pagesën e pensioneve për shfrytëzuesit e rinj të pensionit të cilët të drejtën e pensionit do ta realizojnë në vitin 2026.

a) Shpenzime për pagesën e pensioneve të rregullta në vitin 2026 parashikohen në shumë prej 117.162,88 milion denarë (nga e drejta e punëtorit) dhe kjo për numrin ekzistues të shfrytëzuesve të pensionit si dhe për numrin e ri që do ta realizojnë të drejtën e tyre në vitin 2026, duke përfshirë edhe harmonizimin ligjor të pensioneve që vlen për shfrytëzuesit e pensionit që e kanë realizuar të drejtën e tyre deri më 28 shkurt të vitit 2026, me një përqindje të projektuar prej 2,7% për harmonizimin e pensioneve të shtatorit.

Në vitin 2026 shpenzime për pensione planifikohen të rriten, si rezultat i harmonizimit të pensioneve dhe në përputhje me rritjen e planifikuar të numrit të pensionistëve të rinj për vitin 2026 me 1,0%.

Numri i shfrytëzuesve të pensionit parashikohet që në fund të vitit 2025 të arrijë në 348.195 shfrytëzues, si vijon:

Nr.r.	Shfrytëzues	2025 (vlerësimi)	Struktura	2026	Struktura	Indeks (4/2)
0	1	2	3	4	5	6
1	Pleqërie	251.000	72,09	253.818	72,17	101,12
2	Invalidore	23.000	6,61	22.922	6,52	99,66
3	Familjare	73.417	21,09	74.151	21,09	101,00
4	Ushtarake	740	0,21	747	0,21	100,99
5	Bujqësore	38	0,01	38	0,01	99,82
	Gjithsej	348.195	100,00	351.676	100,00	101,00

Në fund të vitit 2026 parashihet që numri i shfrytëzuesve të pensionit të arrijë në 351.676 shfrytëzues. Kjo përfaqëson një rritje prej 3.481 shfrytëzuesish, përkatësisht një rritje prej 1,0%. Nga ky numër, planifikohet që 2.818 persona të realizojnë të drejtën e pensionit të pleqërisë, ndërsa të shfrytëzues tjerë parashikohet një reduktim të: shfrytëzuesit e pensionit invalidor të zvogëlohet për 78, shfrytëzuesit e pensionit familjarë të rriten për 734. Edhe gjatë vitit 2026 pritet të vazhdojë rritja e numrit të shfrytëzuesve të pensionit si rezultat i realizimit të të drejtës së pensionit vetëm përmes plotësimit të kufirit të moshës.

Gjithsej pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2026 planifikohet të arrijë shumën prej 27.522,00 denarë, apo për 3,85% më shumë në krahasim me dhjetorin e vitit 2025, kur pritet të jetë rreth (26.500,00denarë). Kjo rritje është rezultat i harmonizimit të rregullt të planifikuar sipas Ligjit të SPI-së si dhe i pensioneve më të larta që realizohen nga pensionistët e rinj krahasuar me pensionet më të ulëta të shfrytëzuesve të ndjerë gjatë periudhës së llogaritjes.

- b) Shpenzimet për pensionet minimale bujqësore planifikohen në shumën prej 6,82 milionë denarë dhe
- c) Shpenzimet për pensionet ushtarake në vitin 2026 planifikohen të arrijnë në 322,39 milionë denarë dhe të njëjtat janë rritur në krahasim me vitin 2025.

1. Shpenzimet e tranzicionit

Me Buxhetin e Fondit për vitin 2026 planifikohen 15.955,00 milionë denarë mjete për kontribute në fondet pensionale private mbi bazën e sigurimit pensional të detyrueshëm me financim kapital. Këto mjete janë planifikuar bazuar në numrin e të siguruarve të anëtarësuar në fondet pensionale private në vitin 2025 dhe anëtarët e rinj të pritshëm që për herë të parë do të punësohen në vitin 2026, të cilët, sipas Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, i plotësojnë kushtet për anëtarësim në sigurimin e detyrueshëm.

Në fund të vitit 2025, vlerësohet se numri i anëtarëve në fondet pensionale private do të jetë rreth 628.637 anëtarë. Në vitin 2026 parashikohet një rritje e punësimit prej 1,6%. Me këtë normë pritet një rritje e numrit të të punësuarve të rinj që do të hyjnë detyrimisht në shtyllën e dytë. Pas

shpërndarjes së kontributeve ndërmjet Fondit dhe fondeve pensionale pensionale, Fondi ka detyrim ligjor që mjetet t'i paguajë brenda afatit prej 5 ditësh.

3. Kompensime për dëmtim trupor

Në vitin 2026, për pagesën e kompensimit në të holla për dëmtim trupor janë planifikuar mjete në shumë prej 123,00 milionë denarë, dhe këto mjete janë në nivelin e mjeteve të vlerësuara për vitin 2025.

4. Kompensimi nga sigurimi invalidor

Për pagesën e kompensimit në të holla mbi bazën e aftësisë së mbetur për punë nga sigurimi invalidor planifikohen mjete në shumë prej 7,50 milion denarë.

5. Shpenzime për akomodim internati të fëmijëve me zhvillim të penguar psiko-fizik

Për pagesën e mjeteve për akomodim internati të fëmijëve me zhvillim të penguar psiko-fizik, është planifikuar një shumë prej 1,5 milionë denarë. Këto mjete janë në nivelin e mjeteve të vlerësuara për vitin 2025.

6. Kontribut për sigurim shëndetësor për shfrytëzuesit e pensionit

Sipas Ligjit për SPI, Fondi ka detyrim të paguajë kontribut për sigurim shëndetësor për shfrytëzuesit e pensionit me normë neto prej 13% mbi pensionin e llogaritur. Për këtë qëllim, me Buxhetin e Fondit për vitin 2026 janë planifikuar mjete në shumë prej 15.231,17 milionë denarë. Këto mjete llogariten me normën prej 13% mbi shumën e pensioneve. Pjesëmarrja e shpenzimeve për sigurim shëndetësor në shpenzimet totale është 10,20%.

7. Kompensimi i Shërbimit Profesional të Fondit

Kompensimi për Shërbimin Profesional të Fondit për vitin 2026 është planifikuar në shumë prej 512,00 milionë denarë për 610 të punësuar. Këto mjete janë parashikuar në përputhje me gjendjen aktuale me 475 të punësuar dhe sipas ndryshimeve të miratuara në Ligjin për Marrëdhënie Pune, me ç'rast pritet një rritje e numrit të të punësuarve. Në Fond nuk janë bërë punësime të reja për disa vite dhe numri i të punësuarve është reduktuar në nivelin më të ulët, gjë që nuk është e mjaftueshme për realizimin e rregullt të detyrave. Për shkak të largimeve natyrore (dalje në pension) dhe arsyeve të tjera, çdo vit ka largime të kuadrit nga Fondi, ndërsa për vite me radhë nuk është pranuar kuadër i ri profesional, si rezultat, obligimet e punës nuk mund të realizohen në kohë, gjë që ndikon në vonesën e

vendimeve dhe pagesën e pensioneve për pensionistët e ardhshëm, të cilët nuk kanë të ardhura të tjera dhe as sigurim shëndetësor.

Sipas planit të ri për punësim për vitin 2026, parashikohet plotësimi i 100 vendeve të punës, për të cilat duhet të parashikohen mjete në buxhetin e Fondit për vitin e ardhshëm, për vendet që janë zbrazur për shkak të largimeve të vazhdueshme të kuadrit nga institucioni për arsye të ndryshme si pensionimi, largimi vullnetar, transferime etj. Gjithashtu, edhe ulja e numrit të personave të angazhuar me kontrata për kryerjen e punës së pavarur, gjë që rrezikon funksionimin normal të institucionit dhe realizimin e veprimtarisë së tij bazë si shërbim për qytetarët.

Spektori i Informatikës në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut prej kohësh përballlet me mungesë të të punësuarve për realizimin e kompetencave të parashikuara, kryesisht për shkak të largimit të kuadrit që është i kërkuar në tregun e punës. Për të parandaluar largimin e këtij stafi të specializuar, Fondi planifikon të lidhë një aneks të Marrëveshjes Kolektive ekzistuese, me të cilin paga e këtyre të punësuarve do të rritet për 15%.

Për këto arsye, Fondi planifikon të punësojë kuadër të ri dhe ka parashikuar mjete për këtë qëllim. Shpenzimet për kompensimin e Shërbimit Profesional marrin pjesë në shpenzimet totale me vetëm 0,34%.

8. Shpenzime të tjera

Shpenzimet për të dala të tjera planifikohen në shumë prej 272,00 milion denarë. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet për mirëmbajtje, shërbimet komunale, materialet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet për taksat gjyqësore dhe financimin e procedurave të falimentimit si dhe shpenzime të tjera për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor. Pjesëmarrja e këtyre shpenzimeve në totalin e shpenzimeve të Fondit është 0,18%. Së bashku me shpenzimet kapitale, këto shpenzime arrijnë në 387,00 milion denarë.

9. Shpenzimet kapitale

Në vitin 2026, për shpenzimet kapitale janë parashikuar mjete në shumë totale prej 115,00 milionë denarë, të cilat përfshijnë:

- 45,00 milionë denarë për furnizimin e kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera.

Shpjegim i detajuar: shtesë

- 20,00 milionë denarë për rikonstrukcionin e objekteve afariste (nga të cilat 15,00 milionë denarë janë planifikuar për Qendrën, filialet dhe ekspoziturat dhe 5,00 milionë denarë për rikonstrukcionin e shtëpive për banim të shfrytëzuesve të pensionit). Me këto mjete të planifikuara synohet të realizohet rikonstrukcioni dhe adaptimi i objekteve afariste të Fondit në Qendër, filiale dhe ekspozitura, si dhe në shtëpitë e pensionistëve, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës për të punësuarit dhe shfrytëzuesit e pensionit.

Shpjegim i detajuar: shtesë

- 50,00 milionë denarë për investime në mjete jo-financiare, për Furnizimin e mallrave që janë objekt i kontratës: “Zhvillimi i një zgjidhjeje të integruar softuerike të bazuar në teknologji moderne, sipas projektit ‘Analiza funksionale e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut (FSPIMV) dhe propozime për modernizimin e tij.’”

Digjitalizimi fokusohet në përmbushjen sa më të madhe të kërkesave dhe nevojave të shfrytëzuesve, që nënkupton ndryshim të qasjes në përdorimin e zgjidhjeve të unifikuara për të gjithë shfrytëzuesit, gjë që reflektohet edhe në ndryshimet teknologjike dhe zhvillimin e tyre.

Shpjegim i detajuar: shtesë

IV. Rezultati financiar

Bazuar në të dhënat për treguesit makroekonomikë për vitin 2026 dhe të dhënat e tjera që lidhen me rritjen e numrit të shfrytëzuesve të pensionit, normën e kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor për SPI, janë përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit, së bashku me mjetet e planifikuara nga Buxheti i Republikës dhe parashikohet që Fondi në vitin 2026 të realizojë të ardhura dhe të shpenzime të balancuara.

Me të ardhurat totale të planifikuara përmes Buxhetit të Fondit për vitin 2026 në shumë prej 149.380,05 milionë denarë, parashikohet të sigurohet mbulimi i të gjitha detyrimeve të planifikuara të Fondit në të njëjtën shumë prej 149.380,05 milionë denarë, përkatësisht kjo përfshin pagesën e rregullt të pensioneve dhe të drejtave të tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor, në përputhje me rregulloren ligjore, si dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme për realizimin e veprimtarisë së Fondit.

Për këtë qëllim, prioritet i veçantë në punën e Fondit edhe në vitin 2026 do të jetë ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve për realizimin e qëllimeve prioritare të Fondit, kontrolli i të dhënave nga pagesa e kontributeve, shfrytëzimi i qëllimtë i mjeteve të parapara në Buxhet, funksionimi racional dhe ekonomik si dhe zbatimi i rekomandimeve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shpenzim racional dhe ekonomik të mjeteve për shpenzimet rrjedhëse.